



## Fleta informative

# Sqarimi për potencialin Formimi paraprak profesional për integrim (PA INVOL)

### Çfarë është një INVOL?

Formimi paraprak profesional për integrim (INVOL) zgjat një vit dhe përgatit

- refugjatë të njohur (letërnjoftim F ose B) dhe persona të pranuar paraprakisht (letërnjoftim F) si dhe
- adoleshentë dhe të rritur në moshë të re nga shtetet BE-/ EFTA- dhe shtetet e treta (letërnjoftim B ose C) dhe
- persona me status mbrojtjeje S

për hyrjen në një formim profesional bazë (certifikata e konfederatës e profesionit = EBA ose dëftesa e konfederatës e aftësimi = EFZ).

Nxënësit punojnë normalisht tri ditë në javë në ndërmarrje, në dy ditë ata ndjekin mësimin në shkollën e specializimit profesional.

### Çfarë është një PA INVOL?

Kush dëshiron të ndjekë një INVOL, pas regjistrimit ftohet tek ask! Për një PA INVOL. Testime të ndryshme të shkurtra dhe një bisedë rreth interesave profesionale mundësojnë pas analizimit një vlerësim, nëse ndjekja e një INVOL-it përbën hapin e përshtatshëm vijues për integrimin e mëtejshëm profesional.

PA INVOL-i është falas, përveç kostove të udhëtimit dhe të ushqimit.

### Regjistrimi për PA INVOL

-Persona të pranuar paraprakisht (F) dhe refugjatë të njohur (F/B): përmes zyrës, që merret me rastin me anë të platformës IT IAS

-Persona nga EU/EFTA/shtetet e treta: përmes [www.ag.ch/invol](http://www.ag.ch/invol)

### Përgatitja për PA INVOL

Nuk mund të përgatitesh për një PA INVOL. Testimet janë të pavarura nga gjuha, pra janë krijuar në këtë mënyrë, që është e mundur të nxirren rezultate të mira edhe pa fjalë.

### Kur zhvillohet PA INVOL-i?

Normalisht gjatë gjithë kohës midis janarit dhe korrikut.

### Kërkesë për një ndërmarrje për formim profesional INVOL

Në kuadër të PA INVOL-it, jetëshkrimori ekzistues adaptohet me mbështetje nga ask!, sipas nevojës, dhe më këtë bëhet një kërkesë për një stazh prove në një ndërmarrje të përshtatshme të formimit profesional. Stazhi i provës ofron një ndihmë të bazuar për marrjen e një vendimi për të gjithë pjesëmarrësit. Kështu pjesëmarrësit mund të kontrollojnë duke qenë afër me praktikën, nëse profesioni i zgjedhur vërtet përkon me idetë e dëshiruara. Në anën tjetër, ndërmarrja e formimit profesional mund të vëzhgojë, nëse një person shfaqet i motivuar dhe i angazhuar për profesionin përkatës. Vetëm kur janë plotësuar këto kushte, kontrata për një INVOL mund të nënshkruhet bashkërisht.

### Fillimi i INVOL-it

INVOL-i fillon gjithmonë në gusht.

### Informata të mëtejshme gjeni në:

- [www.ag.ch/invol](http://www.ag.ch/invol)

- [www.hallo-aargau.ch/](http://www.hallo-aargau.ch/)
- [www.berufsberatung.ch](http://www.berufsberatung.ch)